Zhotitt kjy astrh te kjiali.
Ndy ju vriti ata, ddezhym gjithy.

SAMUELI: Gjith atá ççy that, u e gjegja. Ngy e bani sott, na arrény ljikk.

ELEAZARI: U ju thom ty mirrhi kitá njeri e ty vriti nani.

ZHEPI: Sa fialja ty ljigga u jam kjy gjegjnja. Oi Kaify, mbaxy ment ata kjy than táterat e tany, mos baççy ty ddezhy ai kjy nga kjiali na arrén te troli ty na banjy mir neve. Ngy e shihi ju he ai astrh i biri ty Zhotitt? Ai ban ty rrónjiny ato kjy ddikjyry. I jeppy drityn atíreve kjy ngy shohyn. Ruani te hakjet e atixy he e shihi gjith drity. Nani kjy astrh kustrhu priççe kett e vriti? Mos báhixy ty kukje. Mua my dhemp zhamera ty gjegjinja ata kjy jini kjy thori. Ngy fjasy ma, ma thom u ty bier zhiarh ka kjiali te krerat e tona ndy na baççym kitá e aí kjy astrh kundr atá kjy u thomy, ngy njóhiny kjíalin e manku Zhotin e math.

KAIF.: Kini fialjy ju, oi Misandri, ty pyrgjegjxy atixy?

MISANDRI: U ngy kamy fialjy ty thom atixy? Ççy my thori mua? O ngy mba ment ata kjy thany my paary? E kush ty ban ty thuaçç he Jesui astrh Missia? Te ku e pee? Mba ment he profetat na than my paaru he kett vinj e ket ddaljy te Judea e jo te Galilea, te ku ddual. Nani my ndiety he ppy ata ççy tha3e my paary, ai astrh